

Manual metodologjik



për vlerësimin e njohurive
në mësimdhënien e historisë online



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education



The
Federal Government



Manual metodologjik për vlerësimin e njohurive në mësimdhënien e historisë online

Botuesi:

Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ)



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education

Redaktore:

Dalliborka Ulareviq

Autorët:

Igor Radulloviq

Milosh Vukanoviq

Dizajni dhe produksioni:

Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ)

Përkthimi në gjuhën shqipe:

Monika Mrnjaçeviq

Elizabeta Mrnjaçeviq

Nikolla Gjonoviq

*Publikimi **Manuali metodologjik për vlerësimin e njohurive në mësimdhënien e historisë online** është pjesë e projektit “Mësimdhënia e Historisë gjatë Pandemisë COVID 19 - qasje e barabartë për të gjithë”, të cilin Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ) e zbaton me mbështetjen financiare të Qeverisë së RF të Gjermanisë.*

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e QAQ-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet si qëndrim zyrtar i Qeverisë së RF të Gjermanisë.

Manual metodologjik

për vlerësimin e njohurive në
mësimdhënien e historisë online

Podgoricë, 2021.



Centar za građansko obrazovanje
Centre for Civic Education



The
Federal Government



Përmbajtja

- 5 Hyrje
- 6 Mësimdhënia e bazuar në rezultate
- 9 Mësimdhënia e historisë që synon mirëkuptim
- 11 Vlerësimi në orën e historisë (online)
- 17 Zhvillimi i aftësive dhe kompetencave
- 21 Vlerësimi i njohurisë dhe kuptimi i temave të ndjeshme dhe kontroverse
- 24 Përfundim

Hyrje

Transformimi i mësimdhënies nga qasja klasike në qasje online ka qenë sfidë e madhe për stafin mësimor dhe institucionet arsimore. Përpjekje e madhe është bërë në këtë proces përmes krijimit të sistemit të ri të punës dhe është e qartë se këtë sistem do ta zbatojmë në të ardhmen e afërt, të paktën edhe një herë, dhe se ende nuk kemi marrë rezultate konkrete të efikasitetit të tij.

Gjatë krijimit dhe zbatimit të këtij sistemi u shfaqën disa sfida - si të kalohet nga klasa klasike në klasë virtuale; si të koordinohet mësimi në kohë reale me mësimin asinkron; dhe si të ndihmonin mësuesit dhe nxënësit në këtë rrugë? Sidoqoftë, sfidë e veçantë ishte vlerësimi i njohurisë. Nëse ndihmat teknike ofruan mundësinë për zbatimin e metodës së re të punës, në vlerësimin e njohurisë bota virtuale vetëm e ndërlikoi situatën.

Siç pritej, u krijua varg strategjish dhe ndihmash që synonin të mundësonin teste klasike të njohurisë në botën virtuale, ose të përfitonin nga avantazhet teknike dhe përmbajtja multimediale për t'i bërë testet më të arritshme, efikase dhe interesante. Sidoqoftë, mbeti dyshim si në potencialin për transferimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive në botën virtuale, ashtu edhe në vlerësimin e tij, veçanërisht kur bëhet fjalë për vlerësimin e të kuptuarit. Nëse flasim për lëndën e historisë, veçanërisht në mësimin e temave komplekse, të ndjeshme dhe kontroverse, nevoja për zhvillimin e të kuptuarit të asaj që është mësuar në vend të transferimit të njohurisë është një nga rëndësitë themelore. Përveç pranimit të fakteve, shumë më e rëndësishme është që nxënësi të mund të japë shpjegim, të gjejë dëshmi dhe të japë shembull, të thjeshtojë, zbatojë (gjejë përdorim), të përdorë analogjinë dhe ta paraqesë temën në mënyra të reja.

Ky manual u krijua me idenë për të siguruar një pasqyrë të sfidave dhe metodologjive në mësimin e historisë online, me qëllim të vlerësimit të njohurive të bazuara në rezultate dhe vlerësimit të njohurisë në mësimin e historisë që synonë të kuptuarit. Autorët shpresojnë që të paktën të lehtësojnë punën sfiduese të mësuesve të historisë dhe edukatorëve të tjerë të historisë.

Mësimdhënia bazuar në rezultate

Qëllimi kryesor i procesit edukativo-arsimor është të aftësojë nxënësit të zbatojnë atë që kanë mësuar në shkollë në fazat e mëvonshme të jetës. Prandaj, qëllimi i mësuesve është që nxënësit të jenë në gjendje të përdorin njohuritë e tyre kur përballen me informacione të reja, por edhe me probleme.

Mësimi modern i historisë, në atë kuptim, ka rol shumë të rëndësishëm. Roli i mësuesit është që, pavarësisht nga mjedisi në të cilin zhvillohet mësimi, të kontribuojë në mbarëvajtjen e këtij procesi.

Pedagogjia bashkëkohore historike i mëson nxënësit si të përdorin argumentet dhe logjikën, por edhe të gjejnë argumente përmes analizës së burimeve, t'i vendosin në kohë dhe hapësirë, ti rishikojnë burimet, të nxjerrin përfundime, vendime... Analiza historike që mundëson aftësinë e zhvillimit të menduarit kritik kërkon burime dhe nxënësit duhet ti bëjnë pyetje burimeve dhe të gjejnë informacion në materialin e zgjedhur nga mësuesi ose nga libri shkollor. Duke përdorur këtë metodologji, nxënësit do të vlerësojnë ndryshimet dhe vazhdimësinë historike, do të përballen me interpretime dhe perspektiva të ndryshme dhe do të kuptojnë kompleksitetin e marrëdhënies shkak-pasojë dhe vështirësinë në përzgjedhjen e burimeve. Studimi i historisë përmirëson vendimmarrjen dhe gjykimin.¹

Edukatorët dhe mësuesit në pothuajse të gjitha vendet e botës sot luftojnë me zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulave bazuar në standardet, rezultatet e të nxënësve dhe vlerësimin objektiv. Njohuritë dhe aftësitë, si dhe pavarësia dhe përgjegjësia që nxënësi ka fituar përmes të mësuarit, reflektohen në rezultatet e të mësuarit të kurrikulës. Rezultatet e mësuarit që vlerësohen përfundimisht duhet të shkruhen në mënyrë që të jenë të qarta dhe pa mëdyshje për të gjithë, veçanërisht për nxënësit, të dinë se si do të maten dhe vlerësohen rezultatet individuale.²

¹ Luisa Black, *History teaching today* – COE. (2011), fq. 4. <https://rm.coe.int/09000016806513c2>

² Marijana Marinović, *Nastava povijesti usmjerena prema ishodima učenja*, Metodički priručnik za nastavnike povijesti, Agencija za odgoj i obrazovanje, Zagreb 2014, fq. 51.

Rezultatet e të mësuarit duhet të jenë specifike dhe të përcaktuar mirë, në mënyrë që të shpjegojnë qartë dhe shkurtimisht aftësitë specifike që nxënësit duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë, zhvillojnë dhe njohin si rezultat të kurrikulës. Gjithashtu prej rezultateve duhet të përjashtohen sa më shumë alternativa në mënyrë që mund ti masim. Objektivat që përshkruajnë rezultatet e planifikuara të të mësuarit si rezultat të mësimdhënies, zakonisht janë të përshtatura në përmbajtjen lëndore dhe në përshkrimin se çfarë duhet bërë me atë përmbajtje.

Rezultatet e të mësuarit online mund të arrihen me spektër të gjerë të metodave të të mësuarit, të tilla si mësimet ndërvepruese, simulime, diskutime online, teste online dhe teste vlerësimi. Vëmendje të veçantë, në atë rast, duhet t'i kushtohet kapaciteteve teknologjike dhe burimeve. Strategjia e përgjithshme e vlerësimit dhe metodat për vlerësimin e përparimit të nxënësit, gjithashtu duhet të përcaktohen si pjesë e procesit të përgjithshëm.

Taksonomia e Blumit e vitit 1956 e qëllimeve arsimore është kuadri tradicional për strukturimin e rezultateve të mësuarit. Nivelet e rezultateve për fushën njohëse sipas Blumit përfshijnë njohuri, mirëkuptim, zbatim, analizë, sintezë dhe vlerësim. Këto kategori renditen sipas shkallës në rritje të kompleksitetit njohës, ku vlerësimi përfaqëson nivelin më të lartë. Është e rëndësishme që rezultatet të deklarohen në të ardhmen, në lidhje me çfarë nxënësit mund të bëjnë si rezultat të mësimdhënies.

Blumi e shihte taksonominë origjinale si pak më shumë se mjet matës. Besonte se kjo mund të shërbente si gjuhë e përbashkët për objektivat e të mësuarit dhe për të lehtësuar komunikimin midis nxënësve dhe mësuesve, lëndëve dhe notave.

Në përgjithësi pranohet, por vlen të përsëritet, që informacionet e fituara gjatë procesit të vlerësimit kryesisht ndikohen nga ajo që i ka paraprirë gjatë procesit mësimor, pasi të dy proceset – udhëzimi dhe vlerësimi – janë në përputhje me qëllimin e deklaruar. Nëse komponentët përputhen mirë, rezultatet e vlerësimit do të jenë mjaft të vlefshëm. Në të kundërtën, nëse komponentët nuk përputhen mirë, rezultatet e vlerësimit do të jenë të diskutueshëm.³

Sigurisht, këtu bëhet pyetje logjike: cilat do të jenë rezultatet e vlerësimit në rrethanat e ndryshme? Kjo vlen veçanërisht për mënyrën dhe mjedisin në të cilin

³ Peter W. Airasian & Helena Miranda (2002) *The Role of Assessment in the Revised Taxonomy, Theory Into Practice*, 41:4, 249-254, DOI: [10.1207/s15430421tip4104_8](https://doi.org/10.1207/s15430421tip4104_8)

janë kryer udhëzimet. Në rrethanat online, për shembull, jemi të vetëdijshëm se ka kufizime të caktuara, për shkak të cilave shpesh jo të gjitha komponentët do të përmbushen plotësisht, kështu që vlefshmëria e vlerësimit mund të vihet në dyshim.

Nëse nxënësit nuk janë në gjendje të kuptojnë se nuk njohin disa aspekte të njohurive faktike, konceptuale ose procedurale, nuk ka gjasa që do të bëjnë ndonjë përpjekje për të fituar ose ndërtuar njohuri të reja. Prandaj, theksojmë nevojën që mësuesit të ndihmojnë nxënësit të vlerësojnë me saktësi njohurinë e tyre.

Duhet gjithmonë të keni parasysh mënyrën në të cilën kryhet procesi i vlerësimit dhe çfarë është në fokusin e tij. Nëse, dhe nuk është e pazakontë, mësuesi është i interesuar kryesisht në mësimin dhe vlerësimin e shkallës se sa nxënësit kanë mësuar përmendësh një përmbajtje dhe a e kanë mbajtur atë në kujtesë për një periudhë të caktuar, ai do të përqëndrohet kryesisht në shkallë të procesit njohës, që lidhet me foljen “të mbani mend”. Sigurisht, kjo qasje pozitive ka shumë të meta, sepse nuk është e përhershme. Prandaj, nëse mësuesi dëshiron të thellojë punën e tij dhe të gjejë mënyra për të rritur dhe vlerësuar mësimin me mirëkuptim, duhet të theksojë shkallën njohëse që shkon përtej mësimit përmendësh.⁴

Sigurisht, gjithçka varet nga temat që studiohen dhe kompleksiteti i tyre. Duket se vetëm një numër i vogël i nxënësve arrijnë plotësisht rezultatet e të mësuarit të historisë që kanë të bëjnë me ndërgjegjen e avancuar, të cilat përfshijnë tema të diskutueshme, pavarësisht faktit se temat e diskutueshme inkurajojnë pjesëmarrje më të madhe të nxënësve në diskutimin online.

4 *Nastava povijesti usmjerena prema ishodima učenja*, fq. 71

Mësimdhënia e historisë që synon mirëkuptim

Vlerësimi i njohurive të nxënësve për lëndën e Historisë mund të jetë mjet i fuqishëm për thellimin e të kuptuarit të nxënësve për përmbajtje të veçantë, por gjithashtu për të ndikuar në zhvillimin e shkrim-leximit, të menduarit analitik dhe aftësisë së pjesëmarrjes qytetare.

Kurrikula e historisë nuk mund të jetë e plotë nëse nuk siguron kuptim të caktuar të rolit aktual të kërkimit historik në përhapjen e njohurive tona për të kaluarën, dhe për sjelljen njerëzore dhe shoqërore.

Në manualët metodologjike dhe literaturën profesionale theksohet se të mësuarit në mësimdhënie duhet të shoqërohet me mirëkuptim. Si qëllim i vlefshëm pedagogjik, theksohet se nxënësit duhet ta kuptojnë atë që kanë mësuar, në mënyrë që njohuria të zbatohet në situata praktike. Kuptimi gjithashtu merret si tipar i vlefshëm intelektual që duhet të ushqehet në mësimdhënie sepse individit i mundëson të analizojë në mënyrë kritike fenomenet në jetën e përditshme dhe të marrë vendime autonome për to.⁵

Fatkeqësisht, shpesh arrijmë në përfundimin se nxënësit kuptojnë shumë më pak se sa pritej. Kjo, në veçanti, shfaqet kur ata nuk vendosin lidhje midis asaj që mësojnë në shkollë dhe asaj që bëjnë jashtë shkollës.

Është bërë e qartë se nëse duam t'i përgatisim nxënësit për atë që i pret në të ardhmen, nuk mundemi të përqëndrohemi më në arsimin si marrje të thjeshtë e njohurive. Në botën e sotme, informacioni është i disponueshëm. Prandaj, arsimi i sotëm duhet ti ndihmojë nxënësve të kapërcejnë vetëm mësimin e fakteve, në mënyrë që të zhvillojnë kuptimin më të thellë të botës rreth tyre dhe diversitetit të shoqërisë globale në të cilën jetojnë. Thjeshtë - nxënësit duhet të mësojnë

⁵ Značaj razumevanja u nastavi (2005), <https://scindeks-clanci.ceon.rs/data/pdf/0547-3330/2015/0547-33301501007D.pdf>

se si të gjejnë, rendisin, vlerësojnë dhe zbatojnë informacionin në situata të reja. Mësimi me mirëkuptim do të ketë ndikim shumë më të madh në transferimin e njohurive sesa thjesht memorizimi i informacionit nga teksti ose ligjëratat. Hulumtimet tregojnë se nxënësit gjatë jetës ndryshojnë mesatarisht midis pesë dhe shtatë punë të ndryshme, kështu që kujtim i thjeshtë informacioni nuk do t'i ndihmojë shumë të mësohen me një realitet të tillë.

Meqenëse qëllimi ynë kryesor është të mësojmë me mirëkuptim, vlerësimi dhe reagimet duhet të përqendrohen në të kuptuarit, jo vetëm në memorizimin e procedurave ose fakteve. Në aktivitetet që inkurajojnë transferimin e njohurive, nxënësit kanë mori mundësisht të zbatojnë aftësitë e të mësuarit dhe ti praktikojnë në situata të reja dhe të ndryshme.

Një nga gjërat që na ka mësuar realiteti aktual, i shkaktuar nga pandemia COVID-19 është fakti që baza e njohurive vazhdon të zgjerohet dhe shumica e mësuesve sot mendojnë se ka shumë material për të mësuar dhe nuk ka kohë të mjaftueshme për t'i paraqitur dhe mësuar të gjitha. Kjo është veçanërisht e pranishme në kuadrin e mësimdhënies online, kur kohëzgjatja e orëve në sistemin arsimor është zvogëluar nga 45 në 30 minuta. Kurrikula përmban shumë tema dhe shpesh është e fragmentuar, pa lidhje të qarta midis temave ose niveleve. Në tekstet dhe kurrikulat tona të historisë, e kaluara paraqitet si histori lineare, e cila ngushton kompleksitetin e historisë dhe dimensionin e ngjarjeve, sepse e kaluara e paraqitur në këtë mënyrë është e thjeshtuar dhe kryesisht e njëanshme. Kur shtohet gjuha emocionale, atëherë nënkuptohet ruajtja e njëanshmërisë, stereotipave dhe intolerancës. Problemi i mësimi linear të Historisë, i cili shpesh është marrëdhënie shkak-pasojë, e ndërlikon më tej procesin mësimor dhe në vend që të kuptojë, e drejton nxënësin drejt memorizimit të thjeshtuar të fakteve historike.

Vlerësimi në orën e historisë (online)

Vlerësimi është një nga aspektet themelore të mësimdhënies. Në rastin e mësimdhënies online, duhet theksuar se ka sfida dhe mundësi të veçanta në vlerësimin e arritjeve të nxënësve. Në mjedis online, mungesa e hapësirës fizike dhe kontakti ballë për ballë, mes mësuesit dhe nxënësit, çon në mënyra të ndryshme të notimit. Mësuesi në distancë nuk mund të thotë nëse nxënësi është i pranishëm, nëse nuk është aktiv, që ndonjëherë është e vështirë të sigurohet.

Mësimi modern i historisë është interaktivë. Mësuesi përshtatet me nevojat e nxënësve. Çdo mësues duhet të kuptojë nevojat e nxënësve, sepse merr reagim nga ata. Ndërveprimi është veprimtari sistemike – mësuesit i japin të dhënat nxënësve dhe marrin rezultate nga ata në formë reagimi. Mësimi interaktiv i historisë është proces shumëdrejtimësh. Nxënësi mund të ndërveprojë me mësuesin, me nxënësit e tjerë, me materialet ose me të tre subjektët. Vlerësimi është aspekti kyç i ndërveprimit, i pozicionuar në qender të procesit të mësuarit, pasi që synon të kuptojë dhe përmirësojë të mësuarit e nxënësve. Gjithashtu është proces i perceptimit të arritjeve të nxënësve.⁶

Në kundërshtim me besimin tradicional se vlerësimi është i dobishëm vetëm si masë se sa mirë nxënësit kanë zotëruar faktet e caktuara, praktika e vlerësimit e përshtatur, rigorozë dhe e menduar gjithashtu mund të udhëheqë mësimdhënien, të përmirësojë të mësuarit e nxënësve dhe të zhvillojë aftësitë e të menduarit specifike për këtë shkencë dhe lëndë.

Në rrethanat e mësimin në distancë, ndërveprimi është zvogëluar, që rezultoi nga mosgatishmëria e sistemit për t'u përshtatur me rrethanat e reja në fillim. Sidoqoftë, me kalimin e kohës, ndërveprimi në mësimin e historisë online u ngrit në nivel më të lartë, pasi nxënësit dhe mësuesit kuptuan se mjetet e caktuara që përdorin në platformat online mund të përdoren më mirë.

Përveç faktit që kemi theksuar shpesh, se situata me mësimin në distancë na

⁶ Luisa Black, *History teaching today* - COE. (2011), fq. 46. <https://rm.coe.int/09000016806513c2>

ka zënë të papërgatitur të gjithëve, duhet të kemi gjithmonë parasysh se mësuesit janë, mbi të gjitha, nxënës të përjetshëm. Mësimi i vazhdueshëm është thelbësor për mësimdhënien efektive dhe mundësitë për zhvillim profesional janë vendimtare për përvetësimin dhe thellimin e njohurive profesionale dhe gjykimin profesional të mësuesve.⁷

Një nga dyshimet që lindi nga krijimi i mësimdhënies online nuk ishte vetëm si të vlerësohen objektivisht nxënësit, por edhe si të bëhet vlerësimi. Tani është e qartë se gjatë vlerësimit të mësimin në distancë, duhet të bëhen një sërë detyrash që mbulojnë disa dimensione të të nxënës, të cilat mund të përdoren në atë mësimdhënie. Metodat tradicionale të vlerësimit janë pak relevante, dhe zhvendosja është bërë drejt inkurajimit të ndërveprimit të nxënësve në projekte në grup dhe aktiviteteve tjera.

Përveç kësaj, është e rëndësishme të theksohet dallimi midis notimit dhe vlerësimit, sepse këta dy terma shpesh ngatërrohen. Vlerësimi është proces i grumbullimit të informacioneve, dhe vlerësimi është gjykim i bërë bazuar në informacione që kemi në dispozicion. Mund të vlerësoni sa kanë mësuar nxënësit duke u bërë sërë pyetjesh që lidhen me rezultatet e mësuarit dhe më pas të vlerësohen përgjigjet e tyre. Pra, edhe pse notimi jep informacion për vlerësim, është vlerësimi që udhëheq faktorin njerëzor në procesin e vendimmarrjes. Kjo do të thotë që mësuesi mund të ketë informacione të mira dhe të merr vendim të këq. Ky ndryshim midis vlerësimit dhe notimit është veçanërisht i rëndësishëm kur vendosim se si t'i vlerësojmë nxënësit bazuar në të mësuarit dhe efektin. Dy mësues mund të ekzaminojnë efektin e të njëjtit nxënës dhe të japin nota të ndryshme. Kjo është mungesa e qëndrueshmërisë që ka bërë disa kritikë të vënë në dyshim besueshmërinë e notave që u japim nxënësve.⁸

Kur bëhet fjalë për testimin dhe vlerësimin, atëherë përqendrohemi në notën përmbljedhëse. Ky është lloj specifik i vlerësimit, i natyrës gjithëpërfshirëse, që

⁷ Mindich, Dan and Ann Lieberman. 2012. *Building a Learning Community: A Tale of Two Schools*. Stanford, CA: Stanford Center for Opportunity Policy in Education.

⁸ *Nastava orijentisana na učenje*, Centar za demokratiju i pomirenje u jugoistočnoj Evropi 2013, fq. 162.

nuk bazohet në vlera dhe nuk përfshin thjesht vlerësim numerik të nxënësve⁹ dhe përdoret për të kontrolluar nivelin e mësuarit në fund të secilës njësi. Mësuesit duhet të kenë kujdes në përdorimin e metodave dhe masave të ndryshme që të kenë plan gjithëpërfshirës, i cili duhet të bëjë dallim midis niveleve të ndryshme të të mësuarit. Kur mendojmë për përmirësimin e cilësisë të mësuarit të nxënësve, nënkuptojmë vlerësimin formues. Vlerësimi formues synon të mbështesë procesin mësimor dhe shpesh quhet vlerësim i të nxënit, dhe zhvillohet në kohë reale, gjatë orës. Ky lloj vlerësimi na jep pamjen më të detajuar të procesit të përparimit të nxënësve.

Sfidat e vlerësimit modern

Mësimdhënia online është më efektive nëse drejtohet nga mësuesit me përvojë në lëndët që japin. Mënyra më e mirë për të ruajtur lidhjen mes arsimit online dhe vlerës së arsimit tradicional është të sigurohet që mësimi në distancë të kryhet nga mësuesit të cilët janë plotësisht të kualifikuar dhe të interesuar për mësimdhënien online.¹⁰

Mësuesit që kanë përvojë në mësimdhënien online, si dhe nxënësit e tyre, theksojnë në mënyrë të barabartë nevojën për kurrikulë të strukturuar qartë, orën e planifikuar mirë dhe mësimin në distancë. Strukturimi efektiv nënkupton planifikimin paraprak, dmth. para procesit mësimor. Strukturat dhe cilësitë organizative që do t'i ndihmojnë nxënësit të mësojnë dhe kuptojnë mjedisin online, përmbajnë numër sfidash komunikimi. Përgatitja gjithmonë kërkon shumë kohë dhe mendim, edhe në kushte reale. E njëjta gjë ndodh kur bëhet fjalë për mësimin në distancë. Në të njëjtën kohë, mjedisi online ofron barriera dhe mundësi të veçanta si për mësuesit ashtu edhe për nxënësit.

Qëndrimet negative ndaj mësimin në distancë mund të rezultojnë nga mungesa e rehatisë në përdorimin e teknologjive të panjohura dhe përballimit të problemeve teknike. Qëndrimet e mësuesve ndaj teknologjive të informacionit -

⁹ Luisa Black, *n. d.*, fq. 47.

¹⁰ Feenberg, A. (1998). "The Written World: On the Theory and Practice of Computer Conferencing." In Mason, R. and Kaye A. (Eds), *Mindweave: Communication, Computers, and Distance Education*. Oxford: Permagon Press. www.emoderators.com/moderators/feenberg.html

komunikimit mund të përcaktojnë shkallën në të cilën këto teknologji përdoren në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Qëndrimi ndaj përdorimit të disa platformave online krijon besime të spikatura te individit në lidhje me pasojat e përdorimit të mëtejshëm dhe vlerësimin e këtyre pasojave. Përveç kësaj, mund të jetë e vështirë për edukatorët të përdorin mjete dhe platforma gjatë realizimit të detyrimeve mësimore. Kjo e fundit mund të shoqërohet me ndryshimet e mëdha në jetë dhe nga stresi psikologjik lidhur me përhapjen e pandemisë.

Shumica e mësuesve sot, procesin e vlerësimit e theksojnë si pjesën më të vështirë të punës. Pavarësisht nga përvoja, nga metodat e ndryshme të aplikuara dhe të ngjashme, gjithmonë ekziston frika se ka ndodhur ndonjë mbikëqyrje. Kjo mund vlen edhe për Histori si lëndë, veçanërisht nëse rezultatet nuk vlerësohen sipas kompleksitetit që ka.

Një sfidë tjetër e mundshme për mësuesit, veçanërisht ata që mësojnë historinë bashkëkohore, është roli që luan historia si disiplinë shkencore në hedhjen poshtë të miteve dhe rishqyrtimin kritik të interpretimeve, supozimeve dhe pikëpamjeve popullore që inkurajojnë pjesë të ndryshme të shoqërisë. Çdo program mësimor evropian ose kombëtar i shekullit XX përfshinë tema, probleme dhe çështje që janë ende të ndjeshme ose të diskutueshme. Duhet të kihet parasysh se disa tema, nëse interpretohen në mënyrë objektive, ose nga perspektiva të ndryshme, mund të shqetësojnë dhe provokojnë kritika nga grupe të caktuara, përfshirë prindërit edhe përfaqësuesit e qeverisë.¹¹

Mësuesit dhe nxënësit vijnë në shkollë dhe klasë me prejardhjen e tyre kulturore. Ata janë produkt i shoqërisë së caktuar, u nënshtrohen kujtimeve, ndikimeve, emocioneve dhe paragjykimeve që prekin familjet dhe komunitetet e tyre. Është e rëndësishme të mendoni dhe të jeni të vetëdijshëm për paragjykimet dhe stereotipet tuaja, dhe si ato janë të integruara edhe në skemat mendore të mësuesve dhe nxënësve. Kjo është e rëndësishme sepse të mësuarit, siç e kemi theksuar, nuk është pasiv. Kur nxënësit mësojnë, ata lidhin informacione të reja me atë që kanë

11 Vidi: R. Stradling i dr., *Teaching controversial issues*, Edward Arnold, London 1984.; C. Gallagher, *History teaching and the promotion of democratic values and tolerance*, Doc. CCED/Hist (96) 1, Council of Europe, Strasbourg 1996.

fituar. Përveç kësaj, mësuesit duhet ta mbajnë debatin në mënyrë objektive.¹²

Një sfidë tjetër e madhe për mësuesit e Historisë është mënyra në të cilën mund të përcaktojnë nëse kompetencat e nevojshme për shoqërinë demokratike janë ndërtuar në procesin mësimor. Kjo është gjithashtu e rëndësishme sepse vlerësimi ka efekte të rëndësishme në sjelljen e nxënësve dhe mësuesve, sepse në procesin e vlerësimit në përgjithësi i kushtohet më shumë vëmendje fushave të kurrikulës që vlerësohen në mënyrë përmbledhëse. Disa metoda notimi, edhe pse të dobishme për vlerësimin e rezultateve të nxënësve në fushat specifike për njohuritë dhe mirëkuptimin kritik historik, nuk janë të domosdoshme në përputhje me mësimdhënien dhe mësimin e fokusuar në praksën demokratike dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Disa metoda gjithashtu mund të kenë mungesë transparence, mungesë respekti për nxënësit, ose mund të kenë ndikim negativ në pikëpamjet e ardhshme të nxënësve. Praktika e vlerësimit duhet të jetë në përputhje me normat dhe vlerat e arsimit, të cilat synojnë forcimin dhe promovimin e vlerave demokratike dhe respektimin e dinjitetit dhe të drejtave të njeriut.¹³

Prandaj, është e nevojshme që koncepti i vlerësimit të përfshijë miratimin e proceseve arsimore dhe konteksteve që pasqyrojnë vlerat e demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Për më tepër, kërkohet që njerëzit të jenë të gatshëm të adoptojnë grup të caktuar vlerash, qëndrimesh dhe sjelljesh, pra kompetencat, të cilat janë të nevojshme për ndërtimin e shoqërisë demokratike.

Arsimi do të ishte joefektiv pa vëmendje të veçantë në zhvillimin e aftësive njohëse, të cilat i ndihmojnë nxënësve të njohin proceset joefikase të vendimmarrjes dhe zgjidhjes së problemeve, të marrin në konsiderim qëndrime të shumta, të ndërtojnë dhe mbrojnë pozicionin e bazuar në arsyetim dhe mbështetje faktike dhe të forcojnë aftësitë intelektuale.

12 Luisa Black, *n.d.*, fq. 38.

13 Council of Europe. (2019, July 25). *Quality history education in the 21st century. Principles and guidelines (2018)*. Democratic Schools for All. <https://www.coe.int/en/web/campaign-free-to-speak-safe-to-learn/-/quality-history-education-in-the-21st-century-principles-and-guidelines-2018->

Është shumë e rëndësishme që të menduarit e nxënësve të stimulohet dhe udhëhiqet vazhdimisht duke siguruar kushte të mira mësimi. Përveç asaj, natyra e lëndës së Historisë u jep nxënësve disa udhëzime se si të ndërtojnë dhe vlerësojnë përgjigjet në kuptimin e arsyeshmërisë së tyre. Së pari, nxënësit duhet të pajisen me mjete për të udhëhequr të menduarit e tyre historik. Udhëzimet fillestare mund të jepen përmes sekuences të strukturuar mirë të të mësuarit. Kjo strukturë duhet të jetë e dukshme në dy nivele. Niveli i parë është përmes strukturimit fillestar të sekuencës së mësimi të temës dhe pyetjes historike. Nuk mund të presim nga nxënësit të kenë njohuri paraprake për ndonjë temë historike. Pajisja e nxënësve me informacione faktike dhe një pyetje sfiduese vlerësimi në fillim të një sekuence mësimore mund të sigurojë një fillim të mirë. Niveli i dytë është strukturimi i ritmit dhe ndryshimi i aktiviteteve mësimore. Përdorimi i disa aktiviteteve mësimore mund të nxisë motivimin dhe përqendrimin e nxënësve. Prandaj, sequenca mësimore duhet të ketë disa aktivitete që sigurojnë ndryshime në atë çka bëjnë nxënësit, por në të njëjtën kohë mendimi i tyre për çështjen historike të mbetet konstant. Për të stimuluar përgjegjësinë individuale, sequenca mësimore duhet të pakëtohet në aktivitete individuale, duke siguruar qëllimet themelore.¹⁴

Kët strukturë duhet ta keni parasysh, sepse nuk mund të pritët nga nxënësit të kenë rezultate komplekse të mësuarit, të tilla si vlerësimi ose sinteza, nëse nuk përmbushen rezultatet themelore, siç është të kuptuarit. Duket se, në mësimin e Historisë, ky segment shpesh neglizhohet, sepse supozohet se disa gjëra dihen *a priori*. Si rezultat, procesi i vlerësimit të njohurive komplikohet më tej dhe ndonjëherë bëhet i pakuptimtë.

Gjatë krijimit të kontekstit historik, nxënësit duhet të kenë njohuri thelbësore. Kjo lloj njohurie ka komponent bazë që krijon kontekstualizim të mëtijshëm, dmth faktet.

Këto fakte japin informacion në lidhje me atë që ndodhi, kush ishte përfshirë dhe në çfarë vendndodhje, si dhe në çfarë kohe ndodhi. Pa to, disa procese historike nuk mund të diskutohen. Ne gjithmonë duhet të kemi parasysh të kalojmë nga i thjeshti (rezultat) në kompleks.

14 *International Journal of Historical Learning, Teaching and Research*, Vol. 11.1, 2012, fq 72-93.

Zhvillimi i aftësive dhe kompetencave

Kompetencat e mësuesve nuk nënkuptojnë vetëm njohuri faktike, të cilat janë relevante për ekspertizën e tyre. Por, kuptimi i tyre më i thellë i koncepteve dhe ideve kryesore reflekton aftësinë e tyre për të transferuar mësimin në kontekst tjetër. Rrjedhimisht, një numër faktorësh duhet të plotësohen në procesin e vlerësimit.

Është e pamundur të arrihet përsosmëria në fushën e matjes së karakteristikave dhe arritjeve të njeriut. Kjo është arsyeja pse ka polemika që shoqërojnë vlerësimin shkollor. Ka shumë faktorë subjektivë dhe objektivë që ndikojnë në (jo)objektivitetin e vlerësimit, të cilët vijnë nga vlerësuesit/mësuesit, nxënësit, lëndët e vlerësimit dhe instrumentet me të cilët vlerësohen. Hulumtime të shumta tregojnë se notat flasin më shumë për atë që vlerëson. Dhe kjo ndodh në situatë kur vlerësohen njohuritë e nxënësve në fushë të caktuar, diçka që në shikim të parë duket e lehtë për t'u matur.¹⁵

Procesi mësimor është vendosur në mënyrë që nxënësit shpejt mësojnë të vlerësojnë ato rezultate të të nxënësve që vlerësohen zyrtarisht, dhe më pak vlerësojnë rezultatet që nuk vlerësohen zyrtarisht. Nëse shikojmë nga ai aspekt, dmth që mësimdhënia që synon të zhvillojë aftësitë dhe mënyrat e të menduarit kërkon aktivitete të ndryshme që vlerësohen, në të cilat nxënësit praktikisht i zbatojnë ato aftësi në materialet burimore. Kështu që mbështetja vetëm në vlerësimin e eseve ose projekteve të nxënësve ku kontrollohet njohuria për faktografinë dhe përsëritja e interpretimeve të mësuesve ose teksteve të këtyre fakteve do të ishte kundërproduktive. Kjo deri diku vlenë edhe për pyetjet që nga nxënësit kërkojnë më shumë sesa thjesht kujtim. Nëse pjesa më e madhe e mësimit të historisë kryhet përmes mësimit të bazuar në aktivitete, atëherë vlerësimi duhet të lidhet me proceset që janë pjesë e aktiviteteve të tilla. Me

15 Grup autorësh, Vlerat dhe virtytet e mia - zhvillimi i aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve, Manuaë për mësuesit e shkollave të mesme, Podgoricë, shkurt 2020, fq 23.

fjalë të tjera, nëse nxënësve u kërkohet të analizojnë dhe interpretojnë pjesë të dokumentit, atëherë aftësia e tyre për të kryer detyrë të tillë duhet të vlerësohet drejtpërdrejt, dhe jo vetëm në mënyrë indirekte përmes vlerësimit të cilësisë së punës së shkruar në temën me të cilën lidhet dokumenti.¹⁶

Gjithashtu, një nga modelet interesante që mund të aplikohet është vetë-reflektimi dhe vetëvlerësimi. Kur nxënësit përfshihen në procesin e vetëvlerësimit, ata krijojnë reagime të brendshme. Gjenerimi dhe veprimi në bazë të reagimeve të brendshme është formë e metakognicionit dhe vetë-rregullimit.

Metakognicioni është në thelb të menduarit për të menduarit e dikujt tjetër, dhe vetë-rregullimi i referohet aftësisë së nxënësve për të koordinuar burimet njohëse, emocionet dhe veprimet në shërbim të arritjes së qëllimeve të të mësuarit.¹⁷

Për shkak të rëndësisë së aftësive për mësim të suksesshëm, mësuesit duhet të sigurojnë që nxënësit t'i zhvillojnë këto aftësi. Përveç faktit që mësuesit shpesh dinë të jenë skeptikë në lidhje me këtë, përqindja e madhe e nxënësve, siç kanë treguar hulumtimet, janë autokritikë kur vetëvlerësohen. Në fund, të mendojmë se sa herë i kemi kërkuar nxënësve të vlerësojnë njohuritë e veta dhe çfarë përgjigjesh kemi marrë. Nëse nxënësve i paraqesim drejtpërdrejt, qartë dhe pa mëdyshje rezultatet që duhet të zotërojnë për cilën notë, do të arrijmë deri në kriter që do t'i lejojë nxënësit të rishqyrtojnë njohuritë e tyre. Kështu, ata do zhvillojnë aftësi jashtëzakonisht të vlefshme, të cilat do të jetë të dobishme për ta, dhe jo vetëm kur bëhet fjalë për lëndën e Historisë.

Një burim tjetër i reagimeve për të mësuar janë bashkëmoshatarët. Informacionet kthyesë të bashkëmoshatrëve kanë përparësi, si për nxënësit që japin informacione kthyesë ashtu edhe për ata që i marrin. Kjo përfshin të menduarit rreth të mësuarit dhe mund të thellojë mirëkuptimin e nxënësve për të mësuar. Hulumtimet tregojnë se njerëzit që ofrojnë informacione kthyesë përfitojnë po aq sa marrësit e informacionit sepse janë të detyruar të inkorporojnë objektivat

16 Stradling, Robert, *Mësimi i Historisë Evropiane të Shekullit 20, Evropa Qendrore*, Zagreb 2003, fq. 203.

17 Boekaerts, Monique. 2006. *Self-Regulation and Effort Investment*. In *Handbook of Child Psychology: Volume 4. Child Psychology in Practice*. 6th ed., edited by K. A. Renninger, I. E. Siegel, R. M. Lerner, and W. Damon, 345–77. New York: Wiley.

e mësuarit dhe kriteret e efektit në kontekstin e punës së dikujt tjetër, që është më pak e ngarkuar emocionalisht sesa puna e tyre.¹⁸

Informacioni kthyes i siguruar nga moshatarët, kërkon të njëjtin kualitet informacioni si informacioni kthyes i mësuesve. Nxënësit duhet të marrin parasysh rezultatet e mësimit dhe kriteret e efektit. Bashkëmoshatarët duhet të analizojnë statusin e mësuarit të bashkëmoshatarëve me të njëjtat kritere suksesi që përdorin për kontrollimin e mësuarit të tyre. Përveç kësaj, siguri i reagimeve konstruktive është aftësia që nxënësit duhet të mësojnë, kështu që udhëzimet duhet të përqëndrohen edhe në këtë.¹⁹

Pavarësisht nga vështirësitë e caktuara me të cilat përballen mësuesit, me organizim të mirë dhe besim se është e mundur, mësuesi i çdo lënde do të jetë në gjendje të gjejë mënyra të punoj me kontiunitet në zhvillimin e personalitetit të gjithanshëm të nxënësve së tij, sipas lëndës që jep, dhe me personalitetin e tij dhe marrdhënien ndaj punës. Duhet të kihet parasysh se çdo mësues arsimon dhe edukon në të njëjtën kohë, dhe se çdo lëndë ka përmbajtje, situata, rrethana që duhet të përdoren për aktivitete edukative.²⁰

Mësimi i historisë mes nxënësve zhvillohet përmes vlerave dhe aftësive,²¹ të cilat janë të nevojshme për funksionimin normal në shoqërinë e sotme. Ndërmjet tyre vlen të përmendet:

- Vlerësimi i dinjitetit njerëzor dhe të drejtave të njeriut;
- Vlerësimi i diversitetit kulturor;
- Vlerësimi i demokracisë, drejtësisë, barazisë dhe rregullit të ligjit;

18 Does assessment hinder learning? Paper presented at ETS Invitational Seminar held on July 11th, 2006 at the Institute of Civil Engineers, London, UK. https://www.dylanwilliams.org/Dylan_Williams_website/Papers_files/Does%20assessment%20hinder%20learning.doc

19 National Research Council (NRC). 2012. *Education for Life and Work: Developing Transferable Knowledge and Skills in the 21st Century*. Washington, DC: National Academy Press.

20 Vlerat dhe virtytet e mia - zhvillimi i aftësive sociale dhe emocionale të nxënësve, fq. 19.

21 Për më shumë në: <https://www.coe.int/en/web/campaign-free-to-speak-safe-to-learn/-/quality-history-education-in-the-21st-century-principles-and-guidelines-2018->

- Hapja ndaj besimeve dhe kulturave të njerëzve të tjera;
- Vetë-efikasiteti;
- Aftësitë analitike dhe të menduarit kritik;
- Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria;
- Aftësitë për zgjidhjen e konflikteve;
- Njohuri dhe kuptim kritik i gjuhës dhe komunikimit;
- Njohuri dhe kuptim kritik i botës përreth.

Studimi i historisë ka kontribut të veçantë në zhvillimin e këtyre aftësive. Ajo ofron njohuri mbi kompleksitetin dhe larminë e sjelljeve të kaluara njerëzore, ushqen aftësinë për të shqyrtuar rrëfime të ndryshme, madje edhe konfliktuale, dhe kërkon që argumentet të mbështeten nga kuptimi i provave të gjera. Por historia në shkollë mund të japë as kontributi vetëm nëse ekziston cilësia e asaj që mësohet, si mësohet dhe e burimeve në dispozicion.²²

Vlerësimi i njohurive dhe kuptimi i temave të ndjeshme dhe kontroverse

Lehtësimi i të kuptuarit është një nga qëllimet më sfiduese të mësimit të historisë në kuptimin e gjerë, veçanërisht kur bëhet fjalë për tema të ndjeshme dhe kontroverse. Kuptimi nuk është qëllimi i vetëm i mësimit (aftësi të ndryshme, vetëbesim, etj.) por shkollat dhe testet shpesh japin pak mbështetje për këtë lloj mësimi. Gjithashtu, shpesh përjashtohet nga strategjitë më të gjera të zhvillimit të mësimit dhe nga procesi i zhvillimit të programeve dhe aktiviteteve të vlerësimit që do ishin më të përshtatshme për vlerësimin e të kuptuarit, edhe pse mësimit që drejtohet drejt të kuptuarit nuk është ide e re.

Lehtësimi i mirëkuptimit është një nga qëllimet më të respektueshme të mësimit. Për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë këtë, përdorim një numër strategjish. Mësuesit përpiqen të shpjegojnë procesin qartë ose kërkojnë mundësi për sqarim. Mësuesit japin detyra kreative, të tilla si planifikimi i eksperimentit ose analizimi i burimeve, ose organizojnë diskutim për problem. Në përgjithësi, japin detyra që kërkojnë dhe krijojnë mirëkuptim. Por mbështetja e nxënësve për të fituar mirëkuptim është punë e vështirë. Treguesi më i qartë është kur nxënësit kanë probleme të shkruajnë ese që tregojnë mirëkuptim të vërtetë ose kur nuk shohin lidhje mes asaj që mësojnë në shkollë dhe asaj që bëjnë jashtë shkollës.

Është e rëndësishme të kihet parasysh se zhvillimi i kuptuarit është proces i vazhdueshëm. Sidoqoftë, kjo pikë mund të kundërshtojë kuptimet intuitive të të kuptuarit. Sigurisht që ka përparime përderisa zhvillojmë të kuptuarit, rrallë ndojnë nxënës arrinë nivelin ku ai i kupton të gjitha që duhet kuptuar për temën e caktuar, sepse gjithmonë ka detyra më komplekse. Duke e pasur këtë parasysh, dhe me qëllim të mësimit realiste, mësuesit zakonisht artikulojnë pritshmëritë për nivel të caktuar të të kuptuarit që duan që të gjithë nxënësit të arrijnë në temën e dhënë.

Të kujtojmë edhe një herë dallimet thelbësore midis njohurisë dhe të kuptuarit. Njohuri do të thotë që nxënësi di diçka dhe mund ta sjellë atë njohuri sipas

kërkesës - na folni ose tregoni aftësinë. Të kuptuarit është aftësi për të bërë më shumë gjëra bazuar në të menduarit për temën - për të dhënë shpjegim, për të gjetur dëshmi dhe shembull, për të thjeshtuar, aplikuar, për të dhënë analogji dhe, në fund, për të paraqitur temën në mënyra të reja.

Shkurt, të kuptuarit është aftësia për të kryer veprim ose “*përformans*” të ndryshëm që tregon kuptimin e dikujt për temë dhe në të njëjtën kohë e përmirësonjë atë. Aftësia është të fitohet njohuria dhe të përdoret në mënyra të reja. Nën kuadrin *Teaching for Understanding Framework*, veprimet e tilla quhen “*veprime të kuptuarit*” ose “*të kuptohet veprimi*”.²³

Edhe pse mund të dallojnë shumë, sipas definicionit veprimet e të kuptuarit duhet t'i çojnë nxënësit në hapësirë më të gjerë se ajo që tashmë e dinë. Shumë veprime të nxënësve janë rutinë për të forcuar procesin e të kuptuarit: përgjigjeje në deklarata në kuize me opsione të ofruara, kryerja e ushtrimeve standarde aritmetike, etj. Këto veprime të tilla rutine janë të rëndësishme, por ato nuk krijojnë mirëkuptim. Është e rëndësishme të mos barazoni performancën rutinë me pak ose më shumë përpjekje për të ndërtuar mirëkuptim.

Si të vlerësoni njohuritë dhe të zhvilloni mirëkuptim për tema të diskutueshme dhe kontroverse? Një nga sfidat më të mëdha është zgjedhja e temës që do të shpjegojë në të gjitha aspektet në mënyrë më efektive procesin e diskutueshëm. Ky proces quhet krijimi i temës gjeneruese. Tema gjeneruese është burimi nga i cili lindin kërkimet, krijohen koncepte dhe kuptime të reja të marrëdhënies shkak-pasojë. Tema gjeneruese është idea kryesore nga e cila mund të lindin mundësitë për kërkim.²⁴

Thjesht, nëse marrim temë të përgjithshme siç është lufta e viteve 90-ta, do të rendisim rreth asaj teme të gjitha temat që lidhen ose si shkak, proces ose si pasojë e atyre ngjarjeve. Duke lidhur të gjitha temat, do të merret pamje e ndërlikuar e lidhjes së temave, por edhe model i qartë i përfaqësimit dhe rëndësisë së mundshme.

Pyetjet që do t'ju ndihmojnë të zgjidhni temën më të rëndësishme gjeneruese:

23 <https://www.gse.harvard.edu/news/uk/08/05/what-teaching-understanding>

24 https://www.wis.edu/uploaded/Academics/Project_Zero/Generative_Topics_By_Ron_Ritchhart.pdf

Cilat tema janë më të lidhura? Cilat tema duken më të rëndësishme? A janë interesante dhe ngacmuese për ju dhe nxënësit? A u ofron tema gjeneruese nxënësve mundësinë për t'u lidhur me lëndë të tjera dhe me jetën jashtë shkollës? Temat gjeneruese janë pyetje, tema, koncepte, ide që ofrojnë mjaft thellësi, kuptim, lidhje dhe diversitet të perspektivës për të mbështetur zhvillimin e të kuptuarit të nxënësve. Ato duhet të jenë interesante për nxënësit dhe mësuesit, në fokus për një ose më shumë disiplina dhe të arritshme për nxënësit.

Thelbi i vlerësimit të njohurive mbi tema të ndjeshme dhe kontroverse është krijimi i orës bazuar në pyetje që do çojnë në krijimin e qëllimeve të kuptueshme: Cila është gjëja më e rëndësishme që dua të mësojnë nxënësit? A është ngushtë e lidhur me temën gjeneruese? A fokusohet në aspektet kryesore të temës gjeneruese?

Ky model duhet të shoqërohet me pyetje që do të çojnë në krijimin e performancës të kuptuarit: A kërkon ky aktivitet nga nxënësi të demonstrojnë mirëkuptim me qëllim të kuptuarit? A kërkon ky aktivitet nga nxënësit të zbatojnë atë që kanë mësuar në situata të reja? A lejon ky aktivitet nxënësve të zhvillojnë dhe të tregojnë mirëkuptim?

Gjithashtu, çdo orë, veçanërisht kur diskutohen temat për ngjarjet e ndjeshme dhe kontroverse, duhet ti prishë paragjykimet dhe qëndrimet e pranuar a joshkencore. Prandaj, gjithmonë duhet të shtrohet pyetja: A shkakton ky aktivitet deluzione, stereotipe dhe mendime të ngurta tek nxënësit?

Vlerësimi i kuptuarit të temave të ndjeshme dhe kontroverse është hap më tej në vlerësimin e mësuesve për atë që kanë mësuar nxënësit. Temat që provokojnë emocione, në të cilat nxënësit kanë ardhur shpesh me paranjohje dhe/ose paragjykime, si të tilla vazhdojnë të shkaktojnë disonancë në shoqëri dhe roli i mësuesve nuk është vetëm të zhvillojë aftësitë kryesore, por përmes tyre ti prish stereotipet dhe iluzionet.

Me krijimin e temave gjeneruese, arrihet sinteza e shkaqeve, ndikimeve, pasojave dhe korrelacioneve me botën moderne përmes përzgjedhjes së ngjarjeve, ndonjëherë më të errëta, ndërsa përmes qëllimeve të kuptuarit dhe përqendrimit në zhvillimin e të kuptuarit ne nuk mund të dështojmë në zhvillimin e aftësive kryesore të mësuarit.

Përfundim

Vlerësimi është, siç është përmendur, pjesë jashtëzakonisht e rëndësishme e ciklit të të mësuarit. Mësuesit duhet të jenë të qartë në lidhje me zgjedhjet e vlerësimit që kanë bërë, domethënë a janë në përputhje me rezultatet e të nxënësve dhe objektivat e mësimdhënies?

Përveç metodave të mësimdhënies, pandemia COVID-19 ka krijuar edhe sfidën e vlerësimit të njohurive të mësimit në distancë. Koncepti i mësimit në distancë inkurajon dhe lehtëson procesin e vazhdueshëm të vlerësimit, i cili ndryshon paradigmat tradicionale të testeve dhe vlerësimeve në fund të çdo periudhe klasifikimi. Kjo qasje siguron reagim të menjëhershëm mbi efektin e nxënësve dhe përcakton hapin tjetër në rrugën e tyre. Rrjedhimisht, një nga rekomandimet që duhet të drejtohet ndaj njerëzve që merren me krijimin e politikës arsimore është heqja e periudhave të klasifikimit, që tani janë gjithsej katër, sepse më heret vlerësimi në periudhë të shkurtër kohe krijoi ankth tek mësuesit dhe nxënësit.

Mësimdhënia online mundëson korrigjim të shpejtë, që lehtëson punën e mësuesve dhe zvogëlon burokracinë. Roli i mësuesit bëhet më i përqendruar në mësimin e nxënësve sesa në vlerësimin e tyre.

Një nga sfidat e ndjera në fillim të procesit ishte se jo të gjithë mësuesit ishin në të njëjtin nivel të përgatitjes për mësimin në distancë. Meqenëse kalimi në mësimin në distancë nuk ishte planifikuar, as nuk kishte kohë për planifikim dhe trajnim mbi këtë temë, disa mësues me aftësi më të dobëta teknologjike ndiheshin të humbur dhe nganjëherë edhe në pozicion vartës. Kjo vetëm konfirmon se mësimi gjatë jetës dhe edukimi i mësuesve është imperativ.

Vetëm për shkak se mësojmë temën e caktuar nuk do të thotë që nxënësit e kanë mësuar ose kuptuar. Nëse transferimi i njohurive është me të vërtetë misioni ynë, nëse kuptimi i thellë është ajo që përpiqemi të arrisim në mësimdhënie, si mund të jemi të sigurtë se e kemi kryer punën tonë?

Sigurisht, pyetje të ngjashme do të bëhen gjithmonë, kështu që është e nevojshme që vazhdimisht ti rishikoni aftësitë madje edhe njohuritë tuaja. Besojmë se zgjidhja e problemit qëndron në përqëndrimin në mësimdhënie që inkurajon mirëkuptimin tek nxënësit, sepse vetëm në atë mënyrë do t'i përgatisim të përballen me sfidat e shumta të jetës në të ardhmen.



Manual metodologjik

për vlerësimin e njohurive në
mësimdhënien e historisë online

